



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 28.04.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berat Lahu (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zariqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kërkoi nga z. Driton Rukiqi, që ta bënë betimin solemn të këshilltarit komunal para Kuvendit. Po ashtu i

Faqe 1 nga 17

njoftoi të pranishmit duke thënë se, që nga kjo mbledhje Rregullorja e punës së Kuvendit do të respektohet me përpikëri, andaj kërkoi nga të pranishmit që ti përmbahen kësaj rregulloreje. Gjithashtu tha se për shkak të numrit të madh të pikave në rendin e ditës, në marrëveshje me kryetarin e Komunës dhe në pajtim edhe me KPF-në, kemi vendosur që të gjitha ato pika ti ndajmë në dysh. Pikat e mbetura do të jenë në rendin e ditës për mbledhjen e radhës e cili planifikohet të thirret në muajin maj.

Pasi që u konstatua kuorumi për këtë mbledhje, u hap diskutimi për rendin e ditës. Gëzim Sveçla, ngriti shqetësim rreth pikave të propozuara në rendin e ditës duke shtuar se në asnjë mbledhje deri më tani rendi i ditës nuk është në përputhshmëri me Planin e punës së Kuvendit. Kërkoi nga kryesuesi që pikat e rendit të ditës të jenë të harmonizuara me Planin e punës së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se, më 34 vota për dhe 2 abstenime, u miratua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022;**
- 3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2022 (TM1);**
- 4. Raporti i punës i Komunës së Prishtinës (7 dhjetor 2021 – 31 mars 2022);**
- 5. Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta;**
- 6. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, të datës 11.02.2022;**
- 7. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore “Tregjet” nga AKP në ndërmarrjen publike lokale;**
- 8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendëshme- Policia e Kosovës, lagja “Arbëria”, rr. “Toni Bler” në Prishtinë;**
- 10. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim “Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë”;**
- 11. Pyetje dhe përgjigje;**
- 12. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstaton se më 41 vota për asnjë kundër dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022

Lidhur me Propozimvendimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Mirsad Vitia tha se në GP i LVV-së i kemi ngritur shqetësimet tona dhe ato janë marrë parasysh nga drejtoresha, nuk kemi çka të shtojmë veçse ta procedojmë tutje.

Donjeta Dragusha, në emër të GP të LDK-së tha se sipas këtij propozimvendimi po e shohim se kemi një shumë të madhe të mjeteve për bartje rreth 44.6 milion euro në total dhe kjo po tregon edhe një herë të keq menaxhimit të buxhetit dhe një menaxhim shumë të dobët të realizimit të projekteve nga i cili më së shumti kanë pësuar qytetarët, duke mos gëzuar asnjë projekt madhor për gjatë 8 viteve të shkuara. Në si grup e përkrahim bartjen e buxhetit si proces dhe si praktikë e përvjetshme.

Leutrim Retkoceri tha se bartja e mjeteve nga viti 2021- 2022 është derivat i buxhetit të Komunës së Prishtinës i vitit paraprak që po e lëmë pas. Arsyeja e bartjes së shumës kaq të lartë është nga kategoria kyçe e buxhetit, ajo e shpenzimeve që ka pasur performancë tejet negative në ekzekutimin e mjeteve. Po ashtu pasojë e këtij suficiti dhe e kësaj bartje nuk është vetëm kjo po është edhe një humbje e 3.5 milion euro që nuk kthehen nga granti qeveritar dhe mund të konstatojmë se ka qenë keq planifikim, procedura burokratike, bllokada dhe mungesë të vizionit në menaxhim dhe ekzekutimin me mjete dhe projekteve në përputhje me rrethanat dhe nevojat që ka Prishtina. Gjithashtu një situatë rënduese ishte edhe mos zgjidhja e bllokimit të OSHP-së, që është në mandatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe rritja e çmimit të mallrave dhe shërbimeve, që Qeveria, Ministria e Financave duhet të merr urgjentisht hapa konkret për të zgjidh këtë çështje. Ftoj dhe kërkoi nga të gjithë akteret në Komunën e Prishtinës që të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta funksionalizoj organin shqyrtues të prokurimit, të merr vendim për subvencionimin e kontratave në bazë të rritjes së çmimeve të bursës ndërkombëtare.

Bahri Gashi tha se problemin e bartjes së mjeteve e diskutuam edhe në mbledhjen e KPF-së, por edhe me shpresën që edhe OSHP-ja të funksionalizohet, por zakonisht ajo e ka një rregull, se bordi i ri i cili vjen ai i anulon të gjitha kontratat, jo çmimet jo ndryshimet mos ti hudhemi të gjitha të OSHP-ja, ne duhet të përgatitemi për kontrata të reja.

Sami Boroci tha se bartja e buxhetit na ka përcjellë edhe në mandatin e kaluar dhe është normale deri në një masë, por kur shifrat janë kaq të larta është shqetësuese për neve. Me që po i referohemi bartjes, një pjesë është për shkak të problemeve me OSHP-në, kjo është e evidente dhe për shkak të keq planifikimit që ka ndodh në mandatin e kaluar. Duhet pasur parasysh në mandatin e kaluar ka pasur pandemi dhe stopim të proceseve të kapitaleve dhe

gjëra të ngjashme. Ne tash e tutje nëse ka rishikim në buxhetin e ri, projektet që i planifikojmë me i pas analizat paraprake dhe studime të fizibilitetit, dhe krejt çka kërkohet mos me pas konteste, sepse po na krijon një rritje apo bartje shumë ma te madhe të vlerës e cila bartet.

Kumrije Shabani -Ramadani tha se bartja e buxhetit është një kategori ligjore, por që është kthyer edhe ne një fenomen të zakonshëm për Komunën e Prishtinës. Performanca e dobët e qeverisjes së kaluar komunale dhe bllokimi i shumë kontratave nga Qeveria e Kosovës, duke mos funksionalizuar organi që vendos për të drejtën e kontratave për operatorët që kanë fituar të drejtën për realizimin e projekteve. Që të mos përsëritën bartje kaq te larta në vijim Qeveria duhet dhe ka për obligim ndaj qytetarëve të Prishtinës që ta zhbllokoj OSHP-në. Vetëm në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë bartur më shumë se 14 milion euro, dhe 44 kontrata të pa realizuara, që shërbimet e qytetarëve nuk janë realizuar fare duke mbetur shumë projekte si në shëndetësi, bujqësi, në infrastrukturë, arsim etj.

Fatmir Dervishi tha se duke u bazuar në vendimin për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022 sipas këtij vendimi të hyrat që barten janë në vlerë afësisht 45 milion euro. Në kategorinë paga dhe mëditje duke u bazuar në lëndët me vendim nga gjykata për kthim dhe kompenzim të zyrtarëve të larguar nga puna, Komuna obligohet që të paguajë në vlerën prej 1 milion euro, mjete të cilat dedikohen për të kompenzuar pagat e punëtorëve të larguar nga punua, si pasojë e mos respektimit të ligjeve dhe procedurave të parapara. Kjo tregon një planifikim, organizim dhe udhëheqje si dhe menaxhim jo profesional dhe jo efikas nga qeveria paraprake. Duke pasur parasysh këtë gjendje të krijuar, kërkoi nga ekzekutivi i Komunës që të marrin shumë seriozisht zbatimin e ligjeve dhe të kryejnë të gjitha obligimet që ju takojnë qytetarëve dhe punonjësve, si dhe me shpresën me një mirë menaxhim në nivelin komunal dhe shfrytëzim sa më efikas të buxhetit të Komunës.

Muhamet Selmani, lidhur me bartjen e mjeteve tha se, te raporti i bartjes sidomos te investimet kapitale te mallrat dhe shërbime, kisha propozua te shtohet dy kolona ku do të evidentohet data kur është nënshkruar kontrata dhe afati i implementimit të asaj kontrate, për arsye se ne i kemi disa kontrata këtu që nuk e dimë as kur kanë filluar as kur kanë mbaruar, dhe nuk i dimë kur i votojmë. Sa i përket vendimeve të OSHP-së, me të vërtetë është problem, por ai problem është i krijuar nga vet ekzekutuesit e Zyrës së prokurimit, kështu që jo vetëm Prishtina por të tjerat komuna janë edhe ma keq, ku janë mbi 800 kontrata në OSHP te cilat presin një vendim, janë mbi 400 milion euro të bllokuara dhe ky është problem ndoshta i krijuar artificialisht.

Feim Osmani tha se në bazë të diskutimeve lidhur me këtë propozimvendim për bartjen e mjeteve po shihet se qëllimin e kemi me ja gjuajt fajin dikujt e jo shumë me qenë azhur që buxhetet tjera kur t'i diskutojmë në fund te vitit apo në fillimin te vitit me qenë sigurisht 100% me numra më të vogël. Nuk është krejtësisht faji i OSHP-së qysh po ceket këtu, sepse nga 133 kontrata, 96 nga ato janë procedua, kanë kalua dhe kanë ngecë rrugës, ndërsa arsyeja e bartjes në këtë tabelë nuk është cekur. Kishte me qenë mirë që ekzekutivi me pas parasysh se ka nevojë shumë të madhe për investime dhe ka sigurisht mënyra me i procedua tutje që me i krye më shpejt së paku këto që bile që kanë qenë të kontraktuara.

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022.

Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar-31 mars 2022 (TM 1)

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar-31 mars 2022 (TM 1), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë. Kryesuesi hapi diskutimin

Ermal Osmani tha se sa i përket këtij raporti mund të kuptojmë se të hyrat tatimore dhe jo tatimore të Komunës gjatë 3 mujorit të parë kanë shënuar rënie të konsiderueshme prej 21.68%, krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak, mbase kjo rënie ka mundur të ndikoj deri diku edhe nga udhëzimi administrativ për lirimim dhe kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë dhe për regjistrimin e automjeteve. Konsideroi se këtij raporti i mungojnë të dhënat dhe krahasimet në vitet paraprake sa i përket të hyrave nga renta, shpronësimet, parkingjet, gjobat, trafiku, gjobat e gjykatës dhe agjensia e pyjeve. Po ashtu nuk ka asnjë të dhënë tek donacionet sa i përket shpenzimeve në investime kapitale..

Jeta Rafuna tha se kur sot Prishtina ka shumë probleme të mëdha të trashëguara dhe të kritikohet sot një raport për tre muajit e parë të vitit dhe tre muajit e parë qeverisës, kur janë paraparë edhe 45 muaji mandat, mendoj se nuk është më vend, e që Kryetari dhe ekzekutivi Komunën e kanë gjetur me probleme jashtë zakonisht të mëdha, prandaj pas gjithë këtyre pengesave, buxheti nuk mundet të ketë realizim të mirë duhet të cekim po ashtu se ky ekzekutiv sot operon me një buxhet të miratuar dhe të përgatitur nga një ish- qeverisje.

Muhamet Selmani tha se duke e pasur për bazë krizën e madhe në këtë periudhë është e dijjshme që buxheti mundet më pas luhatje, mirëpo si përqindje është i kënaqshëm se është 21.1% të totalit të buxhetit, çka nënkupton që është parametrat 1/4 të buxhetit të realizuar për këtë periudhë. Një pjesë e buxhetit të të hyrave vetanake sigurohet edhe nga lejet e ndërtimit, por duke pasur parasysh krizën e madhe globale sidomos në gjërat ndërtimore nuk kemi të hyra të mjaftueshme nga lejet e ndërtimit dhe një rishikim i buxhetit do të ishte i mirë seardhur. Sa i përket realizimit të buxhetit e që është mbi 20%, te mallrat dhe shërbimet, mendoj se është një realizimi i kënaqshëm, ndërsa te investimet kapitale është periudha janar-mars, është periudha më e varfër e investimeve kapitale, sepse në këtë fazë vetëm hapen tenderë, lidhja e kontratave nuk mundë të realizohet.

Fiknete Bejta tha se te ky raport financiar vërejmë një shumë të kontigjencave, ku janë diku një milion euro, e që Komuna e ka obligim të bënë pagesën ndaj paditësve apo kontesteve gjyqësorë. Propozoi që, Drejtoria e Financave ta ketë parasysh që në

buxhetin e ardhshëm të mundohet të planifikohet, d.m.th të pranohet si obligim ndaj mësimeve të pagesa e shujtës në mënyrë që të kursejmë buxhetin ndaj obligimeve për përmbaruesit.

Nora Kelmendi kërkoi të dijë se si do të veprohet me banesat në lagjen “Kodra e Diellit” që shfrytëzohen nga ish- drejtorët dhe zyrtarë tjerë të Komunës, që nga viti 2007, në kohën e qeverisjes së LDK-së. Si do të vazhdoen këto kontrata dhe a do të formohet ndonjë komision i ri i cili do të bënë vazhdimin e këtyre kontratave.

Gëzim Sveçla, po ashtu kërkoi nga Kryetari një opinion rreth shfrytëzimit të banesave nga ish- drejtorët dhe zyrtarë tjerë të Komunës në kohën e qeverisjes së LDK-së.

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe disa çështje tjera të ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtoreshë, Doruntina Maloku, drejtoreshë dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar-31 mars 2022 (TM 1).

Pika e katërt

Raporti i punës së Komunës së Prishtinës (7dhjetor 2021 – 31 mars 2022)

Lidhur me Raportin e punës së Komunës së Prishtinës (7dhjetor 2021 – 31 mars 2022), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla tha se këtë raport të punës së Komunës së Prishtinës e kemi analizuar dhe kemi konstatuar se përveç se është dëshpërues ky raport është edhe shqetësues, dëshpërues për realitetin që po jetojmë me këtë qeverisje që së shpejti i bënë pesë muaj, shqetësues për qasjen ofenduese ndaj qytetarëve të Prishtinës që e keni shpërfaq me këtë dokument.

E kemi parasysh rritjen e presionit publik në raport me punën realisht me mos punën tuaj për këto pesë muaj në pushtet, po duket se jeni të pa shpresë por kjo nuk ju jap të drejtën të përpiloni pamflete dhe fletushka të tilla dhe të njëjtat tua servoni qytetarëve të Prishtinës.

Jemi të zhgënjyer dhe të irrituar me guximin e zyrtarëve komunal edhe me të juajin kryetar për të lëshuar në publik një dokument të tillë me shumë të pavërteta, me tendenca manipuluese e në shumë raste me përmbajtje qesharake.

Konstruktivitetin tonë në raport me zhvillimet që kanë të bëjnë me punë të rëndësishme për qytetin dhe për qytetarët e kemi shprehur qysh nga seanca e parë, po e dëshmojmë çdo dit, çdo seancë me çdo votim besoj se e keni vërejtur këtë, por asesi nuk lejojmë të na përbuzni e ofendoni me një raport si ky as neve e as qytetarët e Prishtinës.

Fisnik Osmani tha se ky raport i sjellur nga kryetari i Komunës mendoj se ka sjellë një standard të ri, jo vetëm në transparencë dhe llogaridhënie, por edhe në respektin ndaj neve si kuvendar e përmes neve edhe tek qytetarët e Prishtinës.

Raporti i punës së kryetarit dhe ekipit të tij i cili është i organizuar në tri shtylla tregon projektet e mëdha për transformimin e Prishtinës, përkushtimin e madh për të trajtuar

problematikat më të mëdha dhe urgjente të cilat nuk u bënë deri sot, pra duke ju referuar temave të trajtuara nga drejtorët dhe drejtoritë për vetëm më pak se 120 ditë. Pra kryetari Rama për herë të parë pas shumë vitesh Prishtinën e bëri me zot shtëpie duke i hapur dyert fillimisht për qytetarët, ambasadorët, agjensitë e huaja, donatorët dhe partnerët strategjik me të cilët Komuna e Prishtinës do të zbatoi projekte të mëdha dhe serioze. Kryetari Rama dhe ekipi i tij i takon e tashmja dhe tetë vitet e ardhshme të kryeqytetit tonë.

Leutrim Retkoceri tha se ne e kemi analizuar raportin e punës së Komunës së Prishtinës dhe e dëgjua edhe kryetarin Rama, dhe vlen të ceket se është hera e parë nga mandati i kaluar që kryetari del dhe prezanton një raport të punës së tij për një kohë kaq të shkurt.

Me shkas të asaj nga sa u tha deri më tani raporti në politikë ndryshon, mirëpo parimet dhe krahasimet duhet të mbesin ato të njëjtat. Në disa projekte që u përmenden dhe në të ardhmen roli dhe kompetenca e Komunës së Prishtinës është e ndërvarëshme nga niveli qendror, mirëpo niveli qendror duhet të ndihmojë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Kryetari Rama dhe ekzekutivit ju urojmë punë të mbarë në projektet në vijim që janë, të cilat kanë sfida, por unë jam i bindur që këto sfida do të kalohen me sukses.

Endrit Zabërgja tha se me publikimin e këtij raporti besoj se na legjitimohet e drejta me i thënë edhe lavdet edhe kritikën tona. Fillimisht kryetar ju përgëzoj për guximin për me synuar projekte të mëdha se ndryshimi nuk vjen pa guxim, gjithashtu dua të ju përgëzoj edhe për intensifikimin e punëve në disa sektorë të veçanta së fundmi.

Prishtina ka shumë probleme të trashëguara edhe i duhet një përkushtim më i madh, kështu që qytetarët nuk janë duke hjekë për projekte kapitale aq sa janë duke hjekë për probleme elementare, kështu që qytetarët kanë nevojë për pastërti, për ndriçim dhe për shumë gjëra të tjera që ndërlidhen me mirëqenien e tyre sociale.

Feim Osmani, rreth këtij raporti u fokusua kryesisht tek Drejtoria e Inspektionit i cili tha se në këtë raport nuk shihet asnjë fjalë që i dedikohet dëmtimit të pyjeve në zonat rurale.

Po ashtu edhe te Drejtoria e Bujqësisë tek përshkrimi i punëve në raport janë futur edhe thirrjet për subvencionet që kanë qenë të shpallura si thirrje në mandatin e kaluar, kështu që brenda tij janë inkorporuar edhe disa thirrje tjera të cilat kanë hyrë tash rishtazi në këtë raport dhe kam përshtypjen që këto do të barten edhe në raportin tjetër të punës, pastaj si të arritura tjera. Do të ishte mirë që të parashihen disa çështje dhe raporti tjetër i punës këto që janë tash dhe kanë hyrë në fazën fillestare dhe janë përshkruar si punë të këtij tremujori, të mos përsëritet në raportin e punës në periudhën tjetër të raportimit.

Amir Simnica tha se raporti i punës njëqind ditor që na është paraqitur nga kryetari dhe ekipi i kryetarit Rama si duket disa nga asamblistët i ka zënë në befasi, sepse nuk janë mësuar që të ketë raport njëqind ditor asnjëherë këtu brenda Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Çka më bëri më së shumti përshtypje është ankesa e opozitës që i kanë bërë tek disa projekte si ato të zgjidhjes së problemit me qentë endacak e disa projekte të tjera për të cilat projekte opozita pretendon se janë neglizhencë e kryetarit Rama.

Lidhur me disa çështje të cilat u ngritën nga parafolësit e që ndërlidhen me disa projekte si ato për ndriçim, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe me 1 abstenim, u miratua Raporti i punës së Komunës së Prishtinës (7 dhjetor 2021 - 31 mars 2022).

Pika e pestë

Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta

Lidhur me Propozimvendimin për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë.

Feim Osman, në emër të GP të LVV-së tha se jemi pro mbështetjes financiare për organizatat e dala nga lufta, por kjo nuk do të thotë se jemi dakord edhe me shumën e ndarë e as me mënyrën se si është bërë kjo ndarje.

Organizatat në fjalë që sa kohë janë në gjendje të rëndë financiare, dhe kjo ka bërë që mos të kenë aktivitete të ndryshme të cilat i kanë zhvilluar në të kaluarën, si për festa që lidhen me luftën edhe për aktivitetet tjera, prandaj duke marrë parasysh Komuna e Prishtinës ka pasur mundësi të mjaftueshme që të takohet me përfaqësuesit e organizatave në fjalë dhe të hartoj një liste të nevojave. Këtë ndihmë të cilën e jep Komuna e Prishtinës edhe pse shumë e nevojshme për këto kategori është edhe e pa mjaftueshme edhe po ashtu e pa analizueshme mirë, andaj me gjithë këto të meta, ne do ta mbështesim subvencionimin për këto shoqata.

Milazim Vitija, në emër të GP të LDK-së tha se për këtë pikë, ne edhe në asamblenë e kaluar e kemi përkrahur unanimisht, kështu që këto kategoritë e dala nga lufta kanë nevojë për përkrahje.

Leutrim Retkoceri tha se ky propozim është iniciuar nga grupi i PDK-së, në mandatin e kaluar, bazuar në kërkesën dhe nevojat që kanë këto tri kategoritë e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, në Prishtinë. Ky është një vendim i vogël, por i rëndësishëm për të rregulluar financimin institucional të këtyre kategorive, ashtu siç është dashur të ndodhte shumë kohë më parë, dhe që ky subvencionim të hynë si linjë e rregullt buxhetore në vitin 2022.

Bahri Gashi tha se edhe ne jemi pro këtij propozimvendimi për subvencionimin e këtyre shoqatave të dala nga lufta.

Gezim Mehmeti tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta.

Endrit Zabergja tha se edhe Nisma Social Demokrate, po ashtu e përkrahi ndarjen e këtyre subvencioneve, duke konsideruar se ndarjet e tilla janë të nevojshme, dhe besoj që kjo asamble dhe ekzekutivi i ri duhet të fokusohet në veçanti në ngritjen e vlerave kombëtarë, dhe respektin ashtu siç e meritojnë këto shoqata.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit rreth subvencionimit të këtyre shoqatave, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 49 për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete të dt. 11.02.2022

Gëzim Sveçla tha se dihet arsyeja pse është kthyer ky vendim edhe një herë në rishqyrtim, për shkak të një padrejtësie që i është bërë grupit të këshilltarëve komunal të LVV-së.

Leutrim Retkoceri tha se vendimi i institucioneve të Republikës së Kosovës duhet respektuar dhe ne si grup i PDK-së në Kuvendin e Prishtinës, do të i respektojmë në plotësi.

Bahri Gashi tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim, me sugjerimin që në të ardhmen me pasur më shumë kujdes kur bëhen këto vendime, mos me bërë kesi lloj gabimesh.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Kryesuesi kërkoi nga GP i LVV-së që ta propozoi një anëtarë nga radhët e LVV-së.

Gëzim Sveçla, në emër të GP të LVV-së, për anëtar të Komitetit për komunitete propozoi Tria Kasumi –Berisha.

Me propozimin e dhënë nga GP i LVV-së, kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 4 kundër dhe 9 abstenime, u miratua Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete të dt. 11.02.2022.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore “Tregjet” nga AKP në ndërmarrje publike lokale

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore “Tregjet” nga AKP në ndërmarrje publike lokale, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Alban Zogaj, nënkryetar.

Tria Kasumi –Berisha tha se ne jemi pro këtij propozimvendimi, por do të kishte qenë mirë që kryetari me kabinetin e tij me pas një plan konkret, që tregtarët mos me qenë në një pozicion të cilin kanë qenë më parë, qysh e dimë prej mandatit të kaluar të cilët nuk e kanë ditur se çka po ndodh me lokalet e zejtarëve që janë afro tetëdhjetë. Nuk e kanë ditur se çka po ndodh me fatin e tyre, e në të njëjtën kohë tregu të cilin ne po e quajmë treg më shumë ka shitje jashtë tregut se sa brenda tregut.

Besoj se Komuna fillimisht ishte dashur me i ndaluar shitësit ambulant që funksionojnë nëpër rrugë edhe jo në treg edhe mandej me e bërë një plan konkret të funksionimit brenda tregut.

Fiknete Bejta tha se ne gjithmonë e kemi konstatuar problemin me gjendjen e tregjeve, mirëpo me statusin e pa definuar në mes Komunës dhe AKP-së, Komuna nuk ka mundur të investoj për ti rivitalizuar këto tregje. Me unifikimin e tregjeve në një ndërmarrje lokale atëherë i jepet mundësi Komunës të investoj, ti rivitalizoi këto hapësira për shitësit në këto tregje. Për mes të hyrave që ata krijojnë, përmes mirëmbajtjes edhe ndërmarrja mund të ketë të hyra të mjaftueshme sa për të funksionuar me disa anëtarë të menaxhmentit pa e tejkaluar numrin e të punësuarve, mirëpo me ju ofruar shërbime edhe cilësore, edhe shërbime në aspektin e pastërtisë së tregjeve.

Muhamet Selmani tha se edhe ne e përkrahim këtë iniciativë për dhënien e autorizimit të kryetarit të Komunës të filloj negociatat për bartjen e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" në ndërmarrje publike lokale. Siç e dimë kjo ndërmarrje është në gjendje jo të mirë ndoshta arsyeja e vetme ka qenë mos pasja e një pronari të saktë të adresimit të problemeve që kanë pasur. Shpresoi që ne së bashku dhe me ndihmën e kryetarit, ta bëjmë një plan se si do të duket dhe si do të funksionoj kjo ndërmarrje në të ardhmen.

Kushtrim Mushica, në emër të GP të AAK-së tha se edhe ne sigurisht duke e parë situatën e tregjeve, gjendjen e tregjeve se çfarë është, pa dyshim që këtë propozim do ta përkrahim dhe shpresojmë që të marrin preventiva që ky treg, kjo ndërmarrje, ato tregje të funksionojnë dhe të jenë sa më të mira.

Gëzim Mehmeti tha se ky propozimvendim sot nuk është dashtë që të votohet, pasi që i njëjti vendim është votuar në këtë Kuvend, më 29.03.2019 nga kryesuesi i Kuvendit Agim Kuleta.

Endrit Zabërgja tha se po ashtu e mbështesim secilin shteg që mund të sjell punë të mira dhe të realizoj në realitet atë çfarë e prezantoi nënkryetari, mirëpo me theks të veçantë përveç nxitjes për përgjegjësi dhe ndërmarrje të reja, besoj që duhet të fokusohemi edhe në funksionalizimin e këtyre që i kemi aktuale e që për fatkeqësi disa prej tyre i kemi në kaos.

Arbër Vokri tha se një propozim ose sugjerim që e kam bërë më herët dhe jam zotuar se do ta bëjë në vazhdimësi, mendoj se është e nevojshme me u themeluar së paku edhe një ndërmarrje e re publike lokale e cila do ta merrte përsipër menaxhimin e sigurimit të jashtëm të objekteve të Komunës, ose objekteve që janë pjesë e institucioneve komunale edhe të higjienës së tyre.

Sami Boroci tha se në momentin kur konsolidohet ndërmarrja e re, a ka me e menaxhuar procesin e ndërtimit kjo ndërmarrje apo Komuna, apo qysh ka me rrjedh ky proces.

Agim Kuleta tha se vendimi i vitit 2019 është në fuqi nuk ka ndryshim. Mendoj që kryetari e ka autorizimin qysh tash edhe e ka pasur që nga dita e parë me vepruar në bazë të atij vendimi. Kërkoj të dijë se a është bërë ndonjë hap në ndërkohë në zbatimin e këtij vendimi nga administrata e kaluar, me që është pak absurde se ne kemi qenë në administratë të kaluar, por tash po dua me e dit çka kanë marr drejtorët e ri, a ka ndonjë lëvizje, a është bërë ndonjë hap në këtë drejtim.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës.

Kryesuesi konstatoi se më 49 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrje publike lokale.

Pika e tetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkzionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Mimoza Sylejmani, drejtoreshë.

Nora Kelmendi, në emër të GP të LVV-së tha se ky propozimvendim i cili na është prezantuar sot është gjysmak dhe si i tillë është i pa plotësuar me dokumentacione përkatëse është edhe i mangët, kështu që me këtë vendim nuk përputhen pjesa tekstuale me atë grafike. Mirëpo në çoftë se në ndërkohë rregullohet kjo atëherë ne si grup i LVV-së nuk do ta bllokojmë, mirëpo sa i përket kopjeve të planit dhe pjesës grafike kjo nuk është në rregull.

Elmire Nikçi - Rexha tha se si GP i LDK-së mirëpresim Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së Operës dhe Baletit në afërsi të Pallatit të Rinisë, ku do të jetë edhe Platforma multifunkzionale që do ta lidh Arbërinë me Pallatin e Rinisë, premtim ky i kryetarit Përparim Rama në fushatën e LDK-së.

Leutrim Retkoceri tha se ne si grup i PDK-së e kemi shpreh qëndrimin tonë se si projekt është i mirë dhe duhet ti hapim rrugë këtij procedimi për dhënien e pronës, me shpresën që të realizohet në kohën e duhur.

Endrit Gashi tha se si grup i AKK-së e përkrahim për miratim këtë vendim.

Gëzim Sveçla ngriti një shqetësim rreth këtij propozimvendimi i cili tha se përderisa aty afër është stadiumi "Fadil Vokrri", ku sipas kriterëve të UEFA-së, ky stadium është i kategorisë së katërt për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare, dhe tash aty do të ndërtohet diçka tjetër, do të thotë ajo pjesa e parkingut nuk do të ekzistoj më. A ka rrezik se do të penalizohemi në këtë drejtim. Po ashtu kërkoi të dijë se cili është roli i Prishtinës në këtë projekt, për derisa ky projekt ka qenë pjesë e negociatave me Ministrinë e Kulturës.

Lidhur me vërejtje dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit për këtë propozimvendim, sqarime të nevojshme dhanë: Përparim Rama, kryetar, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë, Arbër Sadiku, drejtor dhe Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkzionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë.

Faqe 1 nga 17

Pika e nëntë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, lagja "Arbëria", rr. "Toni Bler" në Prishtinë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Nora Kelmendi tha se ky dokumentacion për këtë pikë nuk është i kompletuar, mungon një kopje e planit, për parcelën 6142-1.

Po ashtu kërkoi të dijë se a ka certifikatë të pronës për këtë objekt, apo ndoshta objekti nuk është i regjistruar.

Jeta Rafuna Hasani tha se ne si grup e kemi shqyrtuar propozimin nga Drejtoria e Pronës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim për Policinë e Kosovës dhe do ta përkrahim për miratim.

Muhamet Selmani ngriti shqetësim rreth shtrirjes së parcelës me nr. 6144 i cili tha se kjo parcelë e pengon qasjen në dy shtëpitë të cilat kapen me objektin për të cilin po flasim, andaj do të ishte mirë që kjo paraprakisht të shikohet me kohë se pastaj kur transferohen është shumë më problem me u korrigjuar përsëri.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, lagja "Arbëria", rr. "Toni Bler" në Prishtinë.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim "Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës"

Për këtë pikë të rendit të ditës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Nora Kelmendi kërkoi të dijë se a është bërë vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe shëndetin e njerëzve, pasi që kjo pronë është afër disa shtëpive.

Jeta Rafuna- Hasani tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Leutrim Retkoceri tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Lidhur me çështjen e ngritur nga znj. Kelmendi, sqarim shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim "Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës".

Pika e njëmbëdhjetë Pyetje dhe Përgjigje

Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Inspekcionit, për nënkryetarin e Komunës dhe për Kryetarin e Komunës

- Kërkoj të dijë se ku jemi në proces me verifikimin e lejes për punët që po bëhen në objektin e zyrave të LDK;
- Z. nënkryetar, para disa ditëve e ke bërë një postim në rrjetet sociale ku keni akuzuar Ministrinë për bllokim të punëve të Komunës së Prishtinës, a vazhdoni të qëndroni pranë atij postimi që Ministria po ju bllokoi në punë;
- Z. kryetar keni dhënë zotim publik se rruga "Muharrem Fejza" do të përfundoj për 40 ditë dhe aty përsëri po vazhdojnë punët;
- Çështjen e trajtimit të qenve endacak e kemi shtyrë për seancën e radhës me propozimin e juaj z. kryetar, a mendoni se duhet të trajtohet kjo çështje, andaj mendoj se duhet gjetur zgjidhje për këtë çështje, nuk e di se çfarë do të diskutojmë ne për aspekte juridike, shqyrtimin e opinionit të cilin e ka kthyer MAPL-ja në këtë rast.

Arbër Vokri, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Çështja e parë ka të bëjë me ankesën e pronarëve të qoshqeve të cilët shprehin pakënaqësinë e tyre rreth largimit të frigoriferëve dhe frizave, ku me 'ç' rast i'u ka rënduar situata ngase pjesën kryesore të fitimit sidomos të muajve të verës i kanë pasur pikërisht prej atyre frizave, frigoriferëve që tash janë detyruar ti heqin. Kërkoj të dijë se a ka ndonjë plan që me e zbutë pak situatën ndoshta me e sjellë një dizajn të ri qoshqeve e që përshtatët edhe me nevojat e shfrytëzuesve të tyre, pra ku mund të përfshihen edhe këta frigoriferë dhe friza;
- Është kërkesë e punëtorëve të gjykatës e cila gjendet në Hajvali si dhe kërkesë e qytetarëve të asaj pjese, që të parashihen linja më të shpeshta të autobusëve, pasi që për momentin është vetëm një qarkullim brenda 60 minutave.

Violeta Salihu, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë

- Banorët e lagjes "Mati 1" kërkojnë të dinë arsyen pse ambulanta atje nuk punon gjatë festave dhe të dielën, me ç' rast për rastet e rënda detyrohen të frekuentojnë në ambulatat e tjera.
- Po ashtu edhe banorët e lagjes "Bregu i Diellit", të njëjtin shqetësim e shprehin për mos funksionimit të ndërrimit të natës, dhe duan ta dinë se ku qëndron çështja lidhur me këtë.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

- Në rrugën "William Shekspir", në lagjen "Kodra e Trimave", në mungesë të kanalizimit ujërat e zeza janë shfaqur mbi tokë dhe në këtë mënyrë po rrezikohet shëndeti i atyre banorëve përreth aty, po ashtu kjo rrugë është e papërfunduar diku afër edhe 500 m. I njëjti problem qëndron edhe afër shkollës "Hilmi Rakovica" aty në mungesë të kanalizimeve janë shfaqur ujërat e zeza dhe në këtë mënyrë po rrezikohet shëndeti i atyre nxënësve që vijnë në shkollë.

Faqe13nga17

- Problem i njëjtë qëndron prapë në "Kodrën e Trimave" në rrugën "Arta" më konkretisht në shtëpinë numër 10 në familjen Mustafaj, ku në mungesë të kanalizimit janë detyruar të hapin një gropë ku në atë mënyrë derdhen edhe ujërat e zeza e në këtë formë ata po rrezikojnë

shëndetin edhe të tyre edhe të banorëve përreth dhe po hasin në vështirësi, sepse pastrimi i asaj pusete duhet të bëhet çdo mbrëmje dhe në këtë mënyrë po hasin në probleme të shumta. Konsideroj se një intervenim i tillë është tejet urgjent për sanimin e gjendjes.

Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë

- Një deponi e mbeturinave inerte që është duke u krijuar dhe po rritet dita ditës në hyrje të autostradës në fshatin "Trud", është një deponi aq e madhe sa që po e shëmton pamjen e panoramës së parë të Prishtinës në hyrje të autostradës aty. A keni ndonjë plan se si të veprohet me at deponi.
- Kur do të publikohet lista e përfituesve të serave, thirrja që është shpallur në muajin janar dhe koha e mbjelljes pranverore të perimeve po kalon, prandaj kjo vonesë i dëmton prodhuesit. A ka mundësi të bëhet shpejt kjo dhe të intervenohet të shfrytëzohet sezona për këtë vit
- A do të kenë përkrahje në ujitje zonat rurale të fshatrave të Prishtinës, kur e kemi parasysh se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë mundësi ta shfrytëzojnë sistemin "Ibër Lepenc" dhe mënyra si do të bëhet kjo.

Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës

- Ka më se tre javë që kemi bërë kërkesë për numrin e të punësuarve në kabinetin e Kryetarit, afati ligjor për përgjigje është 7 ditë dhe ne nuk kemi marr akoma përgjigje, pse po mungon transparenca në këtë rast z. Kryetar;-
- Janë disa zona ku për mendimin tim i vlerësoj si të rrezikshme bëhet fjalë për mbrojtëset tek Albi Mall që tejkalojnë qytetarët për të dal tek Viva Fresh ose anasjelltas, çështje e ngritur nga shumë qytetarë;
- Po ashtu semaforët afër parkut "1 Tetori" janë në shpërputhje me zebrat, ku kohëve të fundit, viteve të fundit janë ardhur ata semafor aty, ndërsa kanë mbetur të vijëzuara zebrat e vjetra do me thënë para çdo semafori janë dy palë zebra dhe po shkakton huti tek shoferët gjithashtu edhe tek kalimtarët e rrugës. Po ashtu mungon vijëzimi me zebra në rrugën "Hyzri Talla" në lagjen "Bregu i Diellit". Po ashtu rruga për te gjykatat është tejet e dëmtuar dhe po ju shkakton probleme edhe bizneseve aty.

Triera Kasumi – Berisha tha se sa i përket çështjes së trajtimit të qenve endacak, në mbledhjen e dytë të rregullt e kam ngritur si çështje këtë temë edhe punën e parcelës. Pavarësisht vendimeve të Ministrisë kam dal edhe në teren e kam vlerësuar edhe punën e prurjeve të prockave të ujit në liqenin e Badovcit dhe e kam parë që ka prurje prej fshatit "Slivovë" e që një fakt i tillë rezulton edhe me raportin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kështu që prapë kisha kërkuar që me e bë një studim të fizibilitetit për këtë parcelë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë: Alban Zogaj, nënkryetar, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Përparim Rama, kryetar, Florian Dushi,

drejtor, Izet Sadiku, drejtor, Ilirik Musliu, drejtor, Plator Gërdovci, drejtor dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Pika e dymbëdhjetë Të ndryshme

Ermal Osmani kërkoi nga ekzekutivi që me rastin e festës së Fiter Bajramit, të stoliset qyteti me disa banera, ku mund ti vendosim në 4-5 vende të sheshit të Prishtinës ose në hyrje të qytetit të Prishtinës, ku në të mund të shkruajmë thjeshtë një fjali "Urime Fitër Bajramin" me një sfond ose një dizajnë me disa bonbone ku mund të proklamojmë pak festë. Nuk është diçka e madhe që kërkohet e që besoj se qytetarët e Prishtinës e meritojnë edhe shpresojë që do ta marr përkrahjen edhe të kolegëve asamblistë por edhe të ekzekutivit.

Triera Kasumi-Berisha, kërkoi nga nënkryetari të dijë se cilat janë hapat që do ti ndërmerrni për qenët endacak në këtë situatë në të cilën jemi, kur do të raportojnë ndërmarrjet edhe ku jemi me rregulloren e "Prishtina Parking".

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Kasumi-Berisha, sqarime të nevojshme dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Milazim Vitija tha se është kërkesë e shumë banorëve të Komunës së Prishtinës, që për regullimin e bartjes së pronës, të hiqet taksa në transaksion. Është rregullimi i pronës gjerësisht trashëgimisë së ngarkesës së pagës në taksën në transaksion, ku mbi 50% të banorëve nuk janë direkt pronarë të paluajtshmërisë e që në fakt janë trashëgimtar, por për shkak të taksës në transaksion që paguhet prej 150 euro për parcelë do të thotë nuk kanë mundësi që të paguhet kjo taksë dhe pengesat e kësaj takse janë të ndryshme dhe shumë jetike. Si pasojë e kësaj qytetarët nëse nuk janë pronarë nuk mund të marrin kredi, hipotekë, nuk mund të realizohen të drejtat e pasurisë, ndarjes fizike, shfrytëzim, banim, ndërtim, nuk mund të realizohen subvencione, përfitime, grande, donacione, aplikim për vizë, e të tjera. Kërkojmë që kjo taksë të hiqet dhe të hapen rrugë që banorët, qytetarët që kanë nevojë ti zhvillojnë procedurat e trashëgimisë, ti realizojnë shpejt dhe pa pengesa, është e paligjshme pasi që vetëm Komuna e Prishtinës dhe e Graçanicës e aplikojnë këtë taksë.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Vitija sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Feim Osmani tha se në muajin prill është dashtë që drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë të na informoi për mbjelljet pranverore dhe kjo nuk na ka ardhur në seancë dhe ne kërkojmë që kjo çështje të trajtohet në seancën e radhës së Kuvendit që do të mbahet më 10 maj dhe konsideroi se pas muajit maj nuk kemi çka të raportojmë për të mbjellurat.

Lidhur me çështjen e ngritura nga z. Osmani, sqarime të nevojshme dha Plator Gërdovci, drejtor.

Rashit Gashi paraqiti shqetësimin e banorëve të zonës "Qendër", konkretisht lagja "Ramiz Sadiku", apo siç e quajnë dhe ndryshe lagja "Pejton", rruga "Jonuz Zejnullahu", e që ndërmarrja "Termokos" nuk po i'u lejon qasje ekonomive familjare që janë aty dhe disa bizneseve, por vetëm banesave, kështu që kisha kërkuar nga nënkryetari që ta shfrytëzon autoritetin e tij.

Faqe15nga17

Me qenëse jemi në prag të "1 Majit" dita ndërkombëtare e punëtorëve ishte pak shqetësuese ajo pjesa e ndarjes së buxhetit prej 1 milion euro për pagesat dhe vendimet gjyqësore karshi punëtorëve, pra kisha shfrytëzuar rastin ti uroj të gjithë punëmarrësit e Komunës së Prishtinës për Pkëtë ditë edhe ti inkurajojë të gjithë ekzekutivin që ti respektojnë sa më shumë të drejtat e punëtorëve.

Gëzim Sveçla tha se LVV-ja qëndron pas atij propozimi për heqjen e taksës në transakcion dhe se këtë propozim do ta votojmë. Ne mendojmë që është e padrejtë për vetë faktin sepse zbatohet prej të gjitha komunave të Kosovës vetëm në dy komuna dhe atë në Prishtinë dhe Graçanicë, pra është koha që ta fusim në rend të ditës për diskutim. Po ashtu mendoj se duhet sa më shpejtë që të merren veprime për çështjen e problemit me qentë endacakë. Duhet shikuar mundësin e një strehimoreje e cila është në Hajvali, e që ky Kuvend e ka votuar në legjislacionin e kaluar, pra ti shikojmë se cilat janë zonat ku është rreziku më i madh, pra mendoj se në këtë drejtim duhet të ndërmerren hapa emergjent.

Triera Kasumi-Berisha, lidhur me çështje e trajtimit të qenve endacak, kërkoi të dijë nga kryetari se a ka ndonjë plan ekzekutivi për ndërmarrjen e masave, që përderisa pikat ushqyese metë vërtetë nuk janë duke na rezultuar qysh duhet për shkak se qenët po krijojnë njëfarë menaxhimi territorial e që ish dashtë menjëherë me e marr një vendim qoftë me i ndarë këto pika ushqyese, qoftë me ndërmarr hapa konkretë, sepse po besoj që jemi në emergjencë. Përveç që qenët po na shkaktojnë neve dëme fizike, psikike ata kanë filluar të dëmtojnë edhe vetura kjo është po besoj që është goxha alarmante, sepse e kemi njëfarë niveli të agresionit krejt tjetër me çka kemi parë deri më tash.

Sa i përket rregullores për NPL "Prishtina Parking", kur saktësisht do të jetë gati kjo rregullore. Lidhur me çështje e ngritura nga z. Gashi, z. Sveçla dhe znj. Kasumi-Berisha, sqarime të nevojshme dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Arbër Vokri tha se sa i përket trajtimit të qenve endacak, e dimë që në fuqi është programi i KSVL-s që është i rëndësishëm, por nuk është i mjaftueshëm dhe për të pasur efekt mendoj që duhet një mënyrë tjetër të aplikohet. Nuk mjafton vetëm një komunë nëse i angazhojmë të gjitha kapacitet jo vetëm të Komunës së Prishtinës por edhe i tërë shteti i Kosovës të merret vetëm me Prishtinën problemi prapë do të rikthehet. Mendoj se edhe propozimi i nënkryetarit për zgjidhjen e këtij problemi përmes eutanazisë, nuk mjafton, kështu që edhe kjo metodë nuk e bënë zgjidhjen e këtij problemi, kështu që mendoj që duhet të shohim mënyra të tjera se si ti adresohemi problemit dhe është bërë problem urgjent.

Valbona Makolli, drejtoreshë tha se sa i përket propozimit të z. Ermal Osmani për stolisjen e qytetit me rastin e festës së "Fiter Bajramit", në buxhetin e Komunës nuk kemi diçka të parapare për këto festa, por nëse ka mënyra tjera si me ndonjë donacion edhe ne e përkrahim, por në procedura të Komunës është pak vonë kjo çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 19:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

Faqe16nga17

